

Në bazë të nenit 38, paragrafi 1, pika 8 dhe 9 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale të Malit të Zi ("Fletorja zyrtare e MZ", nr. 2/2018 dhe 34/2019), nenit 42, paragrafi 1 pika 8 dhe 9 të Statutit të Komunës së Ulqinit ("Fletorja zyrtare e MZ – dispozitat e komunës", nr. 5/07, 9/09 dhe 16/11), nenit 26, paragrafi 2 të Vendimit për vendosjen, ndërtimin dhe heqjen e objekteve të përkohshme të karakterit montazh në territorin e Komunës së Ulqinit "Fletorja zyrtare e MZ – dispozitat e komunës", nr. 24/2016 dhe 31/2018, Kuvendi i Komunës së Ulqinit në mbledhjen e mbajtur, më ____ . ____ . 2019 ka nxjerr

VENDIMIN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR PËRCAKTIMIN E KOMPENSIMIT PËR RREGULLIMIN, SHFRYTËZIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E PËRKOHSHËM TË TOKËS NË PAJTIM ME PLANIN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME

Neni 1

Në Vendimin për përcaktimin e kompensimit për rregullimin, shfrytëzimin dhe shfrytëzimin e përkohshëm të tokës në pajtim me planin e objekteve të përkohshme "Fletorja zyrtare e MZ – dispozitat e komunës", nr.13/2013, 15/2013 dhe 23/2014, pas nenit 9a shtohet një nen i ri 9b që është:

"Në procedurën e lëshimit me qira të tokës së komunës për qëllim të vendosjes së objekteve të përkohshme, kriteret për zgjedhjen e ofertës më të volitshme janë:

- | | |
|---|---------|
| 1.1. Çmimi më i lartë i ofruar | 70 pikë |
| 1.2. Shfrytëzimi i lokacionit në periudhën e kaluar | 30 pikë |

Oferta më e volitshme fitohet në atë mënyrë që vlerësohet me pikë çdo kriter, kështu që ofertuesi më i volitshëm sipas secilit kriter fiton numrin maksimal të pikëve i caktuar për atë kriter, ndërsa ofertuesi i radhitur i dyti fiton numër proporcionalisht më të vogël të pikëve, e pas kësaj pikët e fituara për secilin kriter mblidhen.

Për lokacionet ku ka oferta në të cilat janë ndarë pikët në bazë të shfrytëzimit të lokacionit në periudhën e mëhershme, pas çdo tërheqjeje eventuale nga oferta të cilit do ofertues, ose në rastin që ofertuesi i zgjedhur në afatin e paraparë nuk e nënshkruan kontratën për qira, bëhet renditja e sërishme e ofertave.

Vlera e një pike në kategorinë e çmimit më të lartë të ofertuar varet nga çmimi më i lartë i ofertuar për lokacionin e caktuar dhe fitohet si vijon:

Vlera e një pike në kategorinë e çmimit më të lartë të ofertuar është e barabartë me shumën monetare më të lartë të ofertuar e ndarë me numrin 70.

Pikët për kriterin e shfrytëzimit të lokacionit në periudhën e mëhershme fitohen nëse ofertuesi dorëzon aktvendimin për veprimtarinë e ushtruar për vitin paraprak për të njëjtin lokacion.

Pikët në bazë të shfrytëzimit të lokacionit në periudhën e mëhershme ndahen edhe në rastin kur lokacioni ka ndryshuar sipërfaqja në metra katrorë ose forma në raport me vitin paraprak".

Neni 2

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e tetë pas botimit në "Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës".

Numër: 02 - _____
Ulqin, më ____ . ____ . _____

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT
KRYETARI
Dr. Ilir Çapuni

Arsyetim

Baza juridike për nxjerrjen e këtij Vendimi është në nenin 38, paragrafi 1, pika 8 dhe 9 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale të Malit të Zi, nenin 26, paragrafi 2 të Vendimit për vendosjen. Ndërtimin dhe heqjen e objekteve të përkohshme të karakterit montazh në territorin e Komunës së Ulqinit.

Me ndryshimet dhe plotësimet e Vendimit për konfirmimin e kompensimit për rregullimin, shfytëzimin e tokës në pajtim me planin e objekteve të përkohshme, përcaktohet kompensimi në bazë të kriterëve që dalin nga ky plotësim.

Mendojmë që këto kriterë janë të arsyeshme dhe që bazueshmëria e tyre është në rregullat Ligjore dhe praktikën pozitive të komunave të tjera dhe NP "Morsko dobro"

Kryetari
Loro Nrekiq